Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2024/0066

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga, Isa Hasani-Kryetar, Vedat Poterqoi-Anëtar dhe Vjosa Gradinaj-Mexhuani- Anëtare, duke vendosur sipas ankesës së (OE) "Doctor Exterminator Ddd Sh.P.K.", kundër Njoftimit për kontratë ose të një konkursi të projektimit të Ministria e Punëve të Brendshme në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit "Shërbime për Deratizim, Dezenfiktim, Dezinsektim për Ndërtesat Qeveritare -Ri tender" me nr. të prokurimit: "214-23-13757-2-1-1" më 03/04/2024, mori:

Vendim

1. Aprovohet, si e bazuar ankesa e OE "Doctor Exterminator Ddd Sh.P.K.", me nr. 66/2024, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Shërbime për Deratizim, Dezenfiktim, Dezinsektim për Ndërtesat Qeveritare -Ri tender" me numër të prokurimit: "214-23-13757-2-1-1", Autoriteti kontraktues/ Ministria e Punëve të Brendshme.

2. Obligohet Autoriteti kontraktues, të bëjë përmisimet në Dosjen e Tenderit/ Njoftim për Kontratë B05, sipas konstatimit të parë dhe dytë të Raportit ekspertit shqyrtues nr;2024/0066, të datës 09.02.2024, të mbështetur nga Paneli Shqyrtues, në arsyetim të vendimit dhe të zgjasë afatin për ofertim sipas ligjit.

3. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP-në për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën për mos respektim të vendimit, OSHP mund të ndërmarrë masa ndaj AK sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës.

4. Meqenëse ankesa e OE ankues aprovohet si e bazuar, bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 18.12.2023, Ministria e Punëve të Brendshme në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me "Shërbime për Deratizim, Dezenfiktim, Dezinsektim për Ndërtesat Qeveritare -Ri tender" me nr. të prokurimit: "214-23-13757-2-1-1".

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës shërbime dhe me vlerë të parashikuar të kontratës 316,560.00 €.

Me 10.01.2024, OE "Doctor Exterminator Ddd Sh.P.K.", ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Më 15.01.2024, Autoriteti Kontraktues ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 22.01.2024, OSHP ka pranuar ankesën nga OE "Doctor Exterminator Ddd Sh.P.K.", me nr. 66/24 për lidhur me aktivitetin "Shërbime për Deratizim, Dezenfiktim, Dezinsektim për Ndërtesat Qeveritare -Ri tender" me nr. të prokurimit: "214-23-13757-2-1-1".

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Përgjigje e AK ne Kërkesën për rishqyrtim:

"Ministria e Punëve te Brendshme -ZPP, pas pranimit te kërkesës për rishqyrtim, ka shqyrtuar vlefshmërinë e te gjitha pretendimeve te palës ankimore, te Operatori Ekonomik Doctor Exterminator D.D.D. Sh.P.K, nga Prishtina. Pas analizës se pretendimeve te cekura ne kërkesën për rishqyrtim, kundër Njoftimit për Kontrate dhe dokumenteve te tenderit te datës 20.06.2023, sqarimeve shtese te publikuara ne platformën elektronike, ne konsultim me njësinë kërkuese AK ka ardhur ne konkludim se nuk kemi te bëjë me shkelje te Neneve të lartë cekuar te LPP-se. Detale dhe argumente për pretendimet e neneve te shkelur dhe pikat ankimore për rishqyrtim te lartcekura nga OE, Autoritetin Kontaktues -Ministria e Punëve te Brendshme, konstaton se ka vepruar ne harmoni te plot me LPP-ne dhe nenet: Neni 1 Qëllimi; Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti; Nenin 7 Barazia ne Trajtim / Jo diskriminim, Neni Përcaktimi i nevojave që duhet përmbushur; Neni 27 Dosja e Tenderit; Nenin 28 Specifikimet teknike dhe Nenin 109 Afatet për Dorëzimin e Ankesës AK-MPB ka trajtuar në mënyrë të barabarta he pa diskriminim te gjithë OE-të ne këtë AP dhe është ne harmoni te plote me LPP-ne dhe aktet tjera dytësore mbi prokurimin publik te zbatueshme ne Republikën e Kosovës.

1. Pretendimet tuaja ankimore mbi kërkesat teknike dhe profesionale, së janë shkelur nenet e lartë cekura, Autoriteti Kontraktues vlerëson se nuk qëndron dhe është i pabazuar, sepse me këto kërkesa të vendosura nuk kemi te bëjë me kurrfarë diskriminimi dhe trajtim të pabarabarte për Operatoret Ekonomik pjesëmarrës ne këtë aktivitet të prokurimit. Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, janë vendosur dhe kërkuar nga AK, ne pajtim me LPP-ne, neni 69,

këto kërkesa te kualifikimit profesionale dhe edukative te stafit menaxherial dhe stafit profesional janë kërkesa minimale për këtë projekt me rendësi te veçantë për AK, të cilat kërkesa përcaktojnë dhe sigurojnë Autoritetin Kontraktues për nivelin e mirëmbajtës, menaxhimit dhe realizimit kualitativ dhe profesional te projektit nga ana e kompanisë ofertuese, proces te menaxhimit dhe realizimit kualitativ te këtyre shërbimeve komplekse. Këto kërkesa mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale, janë minimale dhe ne harmoni me LPP-në. AK, për Stafin profesional për realizim te këtij projekti, nuk ka kërkuar ti kenë ne marrëdhënie pune por ka mundësuar të Operatori Ekonomik pjesëmarrës te ofrojnë Kontrate ose marrëveshja e punës valide me punëdhënësin për këtë projekt (kopje), andaj në këtë rast nuk kemi te beje me shkelje le asnjë Neni te LPP-se. AK -Është ne harmoni të plotë me Neni 69 te LPP-se: paragrafi; 4. Ne procedural që shpien ne dhënien e kontratës publike në të cilën përfshihet sigurimi i shërbimeve, autoriteti kontraktues mund te kërkojë nga operatoret ekonomik te siguroje të dhënat mund të kërkohen me shkathtësitë, efikasitetin, kapacitetin, përvojën the besueshmërinë. Te dhënat përkitazi me aftësitë teknike te operatorëve ekonomik mund të parashtrohen përmes një ose me shume mjeteve ne vijim, sipas llojit, sasisë the qëllimit te shërbimeve qe duhet të furnizohen: 4.1. kualifikimet shkollore dhe profesionale te personelit udhëheqës te operatorit ekonomik dhe ne veçanti, te personit ose personave te drejtpërdrejt është ose janë përgjegjës për sigurimin e shërbimeve; 4.4. raportin mbi fuqinë mesatare punëtore dhe numrin mesatar te personelit udhëheqës te operatorit ekonomik për secilin nga tri vitet e fundit; 4.5. raportin mbi mjetet, stabilimentet ose pajisjet teknike qe janë ne dispozicion te operatorit ekonomik për realizimin e shërbimeve.- Duke u mbështetur ne shtjellimet e larte cekura, kompleksitetit të këtij aktivitet te prokurimit i cili ka te bej me shërbime për Deratizim, Dezenfiktim, Dezinsektim në ndërtesat qeveritare dhe përdorimi e preparateve me materie te rrezikshme ku ky shërbim duhet te kryhet ne ambiente te cilat janë te mbushura me staf (njerëz) dhe ne te njëjtën kohe kemi te bëjmë me ruajtje e shëndetit te përgjithshëm publik AK edhe një here konstaton që kërkesat e vendosura janë minimal jo diskriminuese dhe te domosdoshme për realizim të këtij projekti. 2. Pretendimet tuaja ankimore për specifikat teknike, që janë shkelur nenet e larte cekura Autoriteti Kontraktues vlerëson se nuk qëndron the është i pabazuar ky pretendim, sepse te gjithat specifikimet teknike janë ne harmoni me nevojat e AK jo diskriminuese dhe favorizuese për asnjë OE, dhe janë te hartuara nga struktura te specializuara te njësisë se kërkesës te cilat janë për përputhje te plotë me I.PP-ne dhe nevojat e AK-së, mbetet përgjegjësi e OE-se qe shpallet fitues deponimi i materialeve (si brejtësve zvarranikeve etj.) sipas legjislacionit ne fuqi në Republikën e Kosove për asgjësim dhe kompetencave ligjore mbi te cilat operon veprimtaria e biznesit. Edhe një here ju sqaroj se është ne kompetence të plote ligjore të AK-se vendosja e kritereve specifike dhe hartimi i specifikave teknike ne harmoni me natyrën e AP-së. Ministria e Punëve te Brendshme-ZPP, pas pranimit te kërkesës për rishqyrtim, ka shqyrtuar vlefshmërinë e te gjitha pretendimeve te palës ankimore te gjitha janë te cekura me larte. Në zbatim te, Ligi nr. 04/1-042 për Prokurimin Publik te Republikës se Kosovës, / ndryshuar the plotësuar me Ligjin Nr. 04/1-237, Ligjin Nr. 05/1-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092 Neni 108/A.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues "Doctor Exterminator Ddd Sh.P.K.", janë parashtruar si në vijim:

Pretendimi i parë (I):" Fillimisht paraqiten pretendimet e përgjithshme të procesit të tenderimit që konsiderojmë se nuk janë respektuar nga AK-ja, as nuk janë marrë parasysh në rastin e paraqitjes së kërkesës për rishqyrtim pra në një formë janë injoruar në tërësi pasi që AK-ja ka vendosur në vendimin e vetë të datës 15.01.2024, për kërkesën për rishqyrtim të dt.26.07.2023, lidhur me aktivitetin e prokurimit (e cila procedurë sipas ankesës sonë edhe është anuluar dhe tani jemi në ritender), pra nuk ka vendosur për aktivitetin e prokurimit "Shërbime për Deratizim,

Dezenfektim, Dezinsektim për Ndërtesat Qeveritare-ritender" me nr. prokurimi: 214-23-13757-2-1-1. OE ankues me datën 26.07.2023, ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim për aktivitetin e prokurimit nr. 214-23-6093-2-1-1, e cila kërkesë përmes vendimit të AK të dt.28.07.2023, është refuzuar, pastaj OE ankuese kundër këtij vendimi paraqet ankesë me dt.31.07.2023, e cila ankesë sipas raportit të ekspertit shqyrtues të prokurimit nr. 2023/0529, rekomandohet të aprovohet pjesërisht ankesa e OE ankues dhe të bëhen përmirësimet e nevojshme në Dosjen e tenderit, kurse OSHP përmes vendimit OSHP.nr.2023/0529 të dt.06.09.2023 e aprovon në tërësi ankesën e OE ankues dhe e anulon aktivitetin e prokurimit duke e kthyer në rivlerësim. Pra, tani jemi në procedurën e ri tenderit. Vendimi i dt. 15.01.2024 nga AK - Ministria e Punëve të Brendshme – Divizioni i Prokurimit i cili mbështet vazhdimin e procesit të prokurimit (edhe pse një gjë të tillë nuk e cek në dispozitiv të vendimit por në fund të arsyetimit pra është i paqartë) është proces jo i rregullt për shkak se fare nuk është vendosur për kërkesën për rishqyrtim të dt.10.01.2024, që do të thotë se nga AK, në mënyrë bllanko e ka marrë copy-paste arsyetimin e vendimit për rastin të parë (214-23-6093-2-1-1) që është anuluar, kurse kërkesën për rishqyrtim të dt.10.01.2024 (214-23-13757-2-1-1), nuk e ka analizuar dhe lexuar qoftë dhe një rresht të saj, andaj këtu kemi të bëjmë me vërtetim tërësisht të gabuar të trajtimit të kërkesës për rishqyrtim të dt.10.01.2024, të cilat do ti listojmë si në vijim: Autoriteti kontraktues ka shkelur nenin 1 par. 1, 2 dhe 3 të Ligjit për Prokurim Publik. Ashtu që neni 3 par.1 i Ligjit për Prokurimin Publik përcakton se "Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen, procedurat që do të ndiqen, të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen nga personat, operatorët ekonomik, ndërmarrjet, autoritetet kontraktuese, koncesionerët e punëve dhe organet publike që zhvillojnë, përfshihen, marrin pjesë ose interesohen, në aktivitetet e prokurimit ose që përfshihen ose kanë të bëjnë me fondet dhe/ose burimet e tilla", e që AK, në mënyrë direkte i shkelë të tre paragrafët e nenit 1 të LPP-së, me rastin e përgatitjes së një specifikacioni të tillë në dosjen e tenderit i cili shumë pak dallon nga dosja e tenderit fillestar (214-23-6093-2-1-1) që është anuluar. Autoriteti Kontraktues ka dështuar të veprojë sipas nenit 7 par.1 të LPP-së, në të cilin përcaktohet se "Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente", lidhur me par.5 të nenit 7 të LPP-së, ceket se "Autoriteti kontraktues nuk do të kërkojë nga operatori ekonomik që të (i) punësojë ose përdorë, ose të mos punësojë ose përdorë, ndonjë person ose ndërmarrje të veçantë për ekzekutimin e çfarëdo aspekti të një kontrate publike, ose (ii) që të furnizojë ose sigurojë, ose të mos furnizojë ose sigurojë, produkte ose shërbime të cilat rrjedhin nga një person, ndërmarrje ose rajon i veçantë gjeografik". Në rast se një kërkesë e tillë është veçanërisht e autorizuar nga ky ligj, ndonjë ligj tjetër ose marrëveshje ndërkombëtare, parametrat e saktë të një kërkese të tillë do të saktësohen në kontratë ose në njoftimin e konkursit të projektimit, ftesën për pjesëmarrje ose tenderim, dhe në dosjen e tenderit. Autoriteti kontraktues e shkel nenin 7 të LPP-së, në të gjashtë paragrafët me rastin e përgatitjes së një specifikacioni të tillë në dosjen e tenderit tek pika 2.4, Kapaciteti Teknik dhe Profesional për shkak se kërkon Agronom, ose Veterinar ose Ekolog, sipas MBPZHR, kurse e ka hequr Epidemiolog, i cili në bazë të kësaj nuk ka mbrojtje shëndetësore publike, as nuk duhet të jetë Agronomi apo Ekologu, por duhet të jetë gjithsesi Epidemolog, pasi që i njëjti për këto veprimtari duhet të jetë domosdoshmërisht. Kurse tek dosja e tenderit tek pika 2.5, Kapaciteti Teknik dhe Profesional, ka kërkuar teknik të veterinarisë e i cili nuk është i domosdoshëm por që është dashur të jetë edhe mundësia për teknik sanitar, për shkak se nëse nuk veprohet në këtë mënyrë paraqet standard favorizues për ndonjë OE, të caktuar e për në të njëjtën kohë edhe është kriter diskriminues. Autoriteti Kontraktues ka shkelur edhe nenin 9 par.1 të LPP-së, përcaktohet se "Para se të fillohet me

ushtrimin e çfarëdo aktiviteti të prokurimit, ZKA i autoritetit kontraktues duhet të sigurojë që të bëhet një vlerësim formal i nevojave dhe që rezultatet e këtij vlerësimi të regjistrohen formalisht me shkrim dhe të ruhen në dokumentacionin e autoritetit kontraktues. Me këtë vlerësim përcaktohen (i) lloji dhe përmasat e sakta të nevojave të veçanta të autoritetit kontraktues që prokurimi i propozuar parasheh t'i plotësojë; (ii) vlera e parashikuar, lloji i propozuar dhe kushtet përmbajtjesore të kontratës publike që do të jenë lëndë e prokurimit të planifikuar; (iii) specifikimet e propozuara funksionale të secilit objekt që do të përfshihet nga një kontratë e tillë; (iv) përfitimet e pritura nga secili objekt i tillë; (v) në rastin e pajisjeve, mallrave të qëndrueshme dhe punëve, përllogaritja e shpenzimeve të deponimit gjatë tërë afatit të përdorimit të objektit, duke përfshirë shpenzimet e blerjes, operative, mirëmbajtjes si dhe vlerës së mbetur; (vi) një njoftim", mbi atë se nëse aktiviteti i tillë i prokurimit ishte përfshirë në planifikimin e prokurimit, në përputhje me nenin 8 të këtij ligji dhe nëse nuk ishte përfshirë, atëherë një deklaratë mbi arsyet e mos-përfshirjes së tillë; dhe (vii) konstatimin e saktë mbi atë se në çfarë mënyre do të avancojë prokurimi përkatës synimet institucionale të autoritetit kontraktues, për arsye se në dosjen e tenderit tek pika 2.4, Kapaciteti Teknik dhe Profesional, pika 6, ceket se operatori ekonomik ose grupi i operatorëve ekonomik duhet të dëshmojnë minimun 6 punëtorë, por që kjo nuk është e mjaftueshme marr parasysh se i njëjti tender që është anuluar herën e kaluar ka qenë me 8 punëtorë, e i cili prapë se prapë ka qenë numër i vogël, kurse me 6 punëtor nuk mjafton që të kryhen 1,508,542.20 metra katror për sipërfaqet e brendshme dhe 1,346,206.00 metra katror për sipërfaqe te jashtme, dhe 111,185 metra katror për repelimin, largimin e dëmtueseve tjerë dhe atë si: gjarpinjve, zvarranikëve të ndryshëm dhe shpezëve, për shkak se shihet qartë se me këtë po favorizohet ndonjë OE, i caktuar me këto kritere. Autoriteti kontraktues ka bërë shkelje të nenit 7 të LPP-së, në rastin kur kanë kërkuar vetëm një gjenerator Ultra Low Volume –ULV, kriter ky i cekur në dosjen e tenderit në pikën 7, nuk është i mjaftueshëm sepse ky proces tenderimi është me të gjitha objektet qeveritare e që objekt qeveritar është edhe objekti i AKI-së, apo Ministrive tjera përkatëse, pra kemi sipërfaqe shumë më të madhe e që nuk mund të kryhet me pompa tjera dhe pa gjenerator, andaj kjo kërkesë vetëm për një gjenerator është në kundërshtim me nenin 7 të LPP-së, për shkak se shihet qartë se me këtë po favorizohet ndonjë OE, që ka vetëm një gjenerator. Autoriteti kontraktues ka dështuar të veproj konform nenit 6 të LPP-së, në të cilin ceket se "Të gjitha autoritetet kontraktuese, janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit", ndërsa autoriteti kontraktues vepron kundër këtij neni e rrjedhimisht kundër ligjit të prokurimit publik në tërësi me rastin e vendosjes së kërkesës për minimum 3 pompa ULV Elektrike dhe 3 pompa ULV Elektronike, (Këto pompa ULV Elektronike nuk ekzistojnë fare) pra duke i kërkuar gjithsej 6 pompa të lartë cekura, kur ka mundur të kërkoj 6 pompa ULV Elektrostatike (edhe pse 6 pompa ULV Elektrostatike janë të pamjaftueshme për realizmin e këtij tenderi), të cilat mund të përdoren edhe për dezinfektim edhe për dezinsektim madje janë edhe shumë profesionale, andaj të njëjtat duhet të kthehen në dosjen e tenderit, për shkak se favorizohet ndonjë OE që mund ti ketë këto pompa që janë cekur në këtë dosje të tenderit, por edhe nëse ekzistojnë prapë se prapë është kriter favorizues dhe jo profesional. Autoriteti Kontraktues ka shkelur edhe nenin 9 par.1 të LPP-së, përcaktohet se "Para se të fillohet me ushtrimin e çfarëdo aktiviteti të prokurimit, ZKA i autoritetit kontraktues duhet të sigurojë që të bëhet një vlerësim formal i nevojave dhe që rezultatet e këtij vlerësimi të regjistrohen formalisht me shkrim dhe të ruhen në dokumentacionin e autoritetit kontraktues. Me këtë vlerësim përcaktohen (i) lloji dhe përmasat e sakta të nevojave të veçanta të autoritetit kontraktues që prokurimi i propozuar parasheh t'i plotësojë; (ii) vlera e parashikuar, lloji i propozuar dhe kushtet përmbajtjesore të kontratës publike që do të jenë lëndë e prokurimit të planifikuar; (iii) specifikimet e propozuara funksionale të secilit objekt që do të përfshihet nga

një kontratë e tillë; (iv) përfitimet e pritura nga secili objekt i tillë; (v) në rastin e pajisjeve, mallrave të qëndrueshme dhe punëve, përllogaritja e shpenzimeve të disponimit gjatë tërë afatit të përdorimit të objektit, duke përfshirë shpenzimet e blerjes, operative, mirëmbajtjes si dhe vlerës së mbetur; (vi) një njoftim", mbi atë se nëse aktiviteti i tillë i prokurimit ishte përfshirë në planifikimin e prokurimit, në përputhje me nenin 8 të këtij ligji dhe nëse nuk ishte përfshirë, atëherë një deklaratë mbi arsyet e mos-përfshirjes së tillë; dhe (vii) konstatimin e saktë mbi atë se në çfarë mënyre do të avancojë prokurimi përkatës synimet institucionale të autoritetit kontraktues" andaj vlerësojmë se AK ka bërë shkelje të këtij neni me rastin e kërkesës për një paisje adekuate për insekte me avull të nxehtë është 100 C, deri në 1800 C, por që temperatura deri në 1800 C, nuk ka por që besojmë se mund të jetë gabim teknik që duhet të përmirësohet. Autoriteti Kontraktues në specifikacionin teknik ka kërkuar që operatori ekonomik duhet të dëshmojë përmes çertifikatave të origjinës dhe të kualitetit të produktit të cekur në specifikimin teknik në dosjen e tenderit për të gjitha preparatet e kërkuara të specifikuara në specifikimet teknike, por që ky specifikim teknik është i gabuar për shkak se çertifikatat e origjinës nuk tregojnë asgjë me tepër se sa nga cili vend vjen produkti, në vend të kësaj që duhet të hiqet krejtësisht duhet të jetë kërkesa për çertifikatën e analizës së produktit si dhe MSDS (Material Safety Data Sheet), ashtu që çertifikata e analizës së produktit tregon saktësisht përbërjen aktive te produktit, pastaj nga cili vend vjen, datën e prodhimit, datën e skadimit etj. Në dosjen e tenderit të mëparshëm (në pikën 10 të DFT të mëparshëm) këto kërkesa kanë qenë shumë mirë të specifikuara kurse tani për arsye të favorizimit është hequr. Tek Specifikimet teknike të detyrueshme, tek pjesa deratizimi pika b, tek Hapësirat e brendshme ceket se duhet të përdoren pllaka ngjitëse të minjëve jo toksik për njerëz sasia e tyre min. 1 copë për 100 m2, kurse fare nuk është cekur se për të qenë i sigurte çdo ngjitës duhet të përcillet me letër nga prodhuesi se nuk janë toksike si dhe OE duhet të posedojë së paku një faturë të blerjes apo DUD të importit për së paku 15,085 ngjitsa të cilat do të përdoren gjatë periudhës kohore të zgjatjes së tenderit. Ndërsa tek pika C, AK ka kërkuar që në disa objekte si podrume, vende afër trafove, kabllove elektrike etj, për rreth hyrjeve duhet të vendosen preparante repelente kundër brejtëseve (minjëve), në formë të granulave apo sprejit me origjinë organike jo të rrezikshme për njerzit dhe mjedisin. Preparati i tillë përdoret në bazë të etiketës së produktit dhe nevojave në teren si dhe sipas kërkesës nga menaxheri i projektit. Por që përdorimi i repelenteve bije ndesh me vetë domethënien e shërbimit deratizim që ka për qëllim eliminimin dhe kontrollin e brejtëseve (minjëve), e jo repelimin e brejtësve nga një hapësirë në tjetrën duke e përsëritur problemin, do të thotë se pika C, duhet të hiqet tërësisht nga kjo dosje e tenderit. E njëjta gjë vlen edhe për shërbimin e Dezinsektimit pika G, në të cilën thuhet se në disa hapësira gjelbëruese për rreth objekteve, me qëllim të largimit të insekteve duhet të përdoren preparate repelente kundër insekteve, në formë të granulave që nuk janë të rrezikshme për njerëzit dhe ambientin, por që përdorimi i repelenteve bije ndesh me vetë domethënien e shërbimit dezinsektimit që ka për qëllim eliminimin dhe kontrollin e insekteve, e jo repelimin e insekteve nga një hapësirë në tjetrën duke përsëritur problemi, do të thotë se pika G, duhet të hiqet tërësisht nga kjo dosje e tenderit. Sa i përket kërkesës DDD, nuk qëndron për shkak se dezinsektimi dhe deratizimi mund të kryhen pa lëvizjen e stafit zyrtar, por as se si të kryhet dezinfektimi në prezencën e tyre, ashtu që kjo pikë apo kërkesë duhet të përmirësohet. Autoriteti Kontraktues ka bërë shkelje të nenit 9 të LPP-së, me rastin e mosharmonizimit të kërkesave në terren dhe numrin e punëtorëve që duhet të jenë të nevojshëm për përfundimin e këtij projekti, pasi që vetë dosja e tenderit tek kapacitet teknik dhe profesional si dhe specifikimet e detyrueshme nuk korrespondojnë me kërkesat elementare të AK, sa i përket stafit dhe aparaturës së kërkuar, kërkesat e vendosura jo profesionale rrezikojnë mirëqenien e stafit zyrtar që punojnë në objektet Qeveritare, duke e ditur që në këtë kohë të globalizimit dhe pandemive që përhapen brenda ditës si dhe modifikimeve

gjenetike të mikro organizmave, me qëllim të bllokimit të funksionimit të qeverive dhe shkaktimit të bllokimit ekonomik përmes luftës biologjike. Me lartë u sqaruan shkeljet e përgjithshme lidhur me procedurën e tenderimit, kurse më poshtë do të paraqesim shkeljet e radhës të AK, në lidhje me ligjshmerinë e vendimit, përkatësisht kundërligjshmërinë e tij. Vendimi i dt. 15.01.2024 nga AK, për refuzim të kërkesës për rishqyrtim, nuk është vendim i ligjshëm për arsye se kërkesa për rishqyrtim ka pasur të bëjë me këtë aktivitet të prokurimit kurse AK përmes vendimit të dt.15.01.2024, ka vendosur për kërkesën për rishqyrtim të dt.26.07.2023, e kjo në kundërshtim me nenin 27 par. 1 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative në të cilin përcaktohet se "Përveçse kur parashikohet ndryshe me ligj, zyrtari përgjegjës zhvillon procedurën administrative, vendos për çështjen, e nënshkruan vendimin si dhe siguron njoftimin e palës", lidhur me nenin 44 par. 1. Të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përcaktohet se "Akti administrativ është çdo manifestim vullneti i një organi publik, që rregullon në mënyrë të njëanshme një marrëdhënie juridike konkrete të së drejtës administrative, me qëllim prodhimin e pasojave juridike", pra AK ka qenë e detyruar të vendos për çështjen për të cilën edhe është parashtruar kërkesa për rishqyrtim si akt administrativ e jo për çështje e cila nuk ka qenë objekt shqyrtimi i kërkesë për rishqyrtim. Mbështetur në nenin 52 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative përcaktohet se "Një akt administrativ është i paligjshëm nëse:1.1. është nxjerre në mungesë të autorizimit nga një ligj", sipas paragrafit 2 të nenit 4 të këtij Ligji; "1.2. organi publik që e nxjerr ka vepruar pa pasur kompetencë; 1.3. është rezultat i shkeljes të dispozitave lidhur me procedurën administrative", lidhur me nenin 53 par. 1 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative ceket se "1. Një akt administrativ mund të anulohet apo shfuqizohet, sipas detyrës zyrtare, nga organi publik që ka kompetenca të nxjerrë aktin, nga organi i tij mbikëqyrës apo nga një organ tjetër i përcaktuar shprehimisht me ligj". Që të gjitha këto parakushte për një vendim të ligjshëm dhe të zbatueshëm e të kuptueshëm nga pala, po ashtu edhe arsyetimi i vendimit nuk është bërë në vlerësim të fakteve dhe provave apo dispozitave ligjore por vetëm ka marr shabllon pretendimet e ngritura në kërkesën për rishqyrtim të procesit të tenderit të kaluar e jo ri-tenderit, andaj edhe arsyetimi si element i detyrueshëm i aktit administrativ është pjesa arsyetuese e tij, duke pasur parasysh këtë rëndësinë e arsyetimit të një akti administrativ e sanksionon edhe neni 48 i Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, në të cilin përcaktohet se: "1. Arsyetimi i siguron palës mundësinë që ta kuptojë aktin administrativ. Arsyetimi përmban: 1.1. paraqitje të shkurtër të kërkesës së palës; 1.2. shpjegimin e situatës faktike mbi të cilën është marrë vendimi; 1.3. shkaqet të cilat kanë qenë vendimtare gjatë vlerësimit të provave; 1.4. bazën ligjore të vendimit dhe arsyen pse është e zbatueshme në rastin konkret; 1.5. shkaqet për të cilat nuk është pranuar ndonjëri nga pretendimet e palëve; 1.6. në rastin e ushtrimit të diskrecionit, shpjegimin pse është ushtruar ai në mënyrën e dhënë në vendim." Lidhur me paragrafin 2 të po të njëjtit nen dhe ligj përcaktohet se: "Një arsyetim që është dukshëm i pamjaftueshëm, i paqartë, kundërthënës apo i pakuptueshëm, është i barabartë me mungesën e tij", në këtë dispozitë ligjore shumë qartë theksohet se akti administrativ duhet të jetë i arsyetuar për shpjegimin e situatës faktike, shkaqet të cilat kanë qenë vendimtare si dhe bazën ligjore, kurse vendimi i AK datë 15.01.2024 nuk plotëson asnjë prej këtyre kushteve ligjore, për shkak se nuk kemi as edhe një fjali të vetme lidhur me arsyetimin e pretendimeve të palës ankuese, as një vlerësim të asnjë provë apo faktit vendimtar dhe nuk kemi as edhe një citim të dispozitave ligjore, e që në mënyrë automatike ky vendim është edhe i kundërligjshëm edhe duhet anuluar në tërësi. Nga shqyrtimi i kësaj ankese, provat e bashkëngjitura, dispozitat e shkelura ligjore, kërkesat e dosjes së tenderit konstatohet në mënyrë të pakontestueshme se OE Ankues ka të drejtë lidhur me pretendimet e ngritura, që të gjitha këto pretendime në një analizë të mirëfillte të provave dhe bazës ligjore dëshmojnë shkeljet e bëra nga AK dhe domosdoshmërinë e anulimit të vendimit të AK.."

Duke u referuar pretendimeve si më sipër "Doctor Exterminator Ddd Sh.P.K.", konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 7, 9 të LPP-së si dhe neni 27 par. 2, neni 44 par.1, neni 52 par. 1.3, neni 53 par. 1, 2, 3 të Ligji Nr. 05/L -031 Për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtresat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 29.01.2024 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 66/2024, ndërsa me datë 09.02.2024 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2024/66 me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, AK të bëjë përmirësimet në dosje të tenderit dhe të zgjasë afatin për ofertim.

Vlerësimi i pretendimit ankimor OE "Doctor Exterminator Ddd Sh.P.K.", - Eksperti shqyrtues përmes Raportit nr. 2024/66 si në vijim:

Konstatimi i parë (I): "Në rastin konkret vlerësojmë se pretendimi ankimorë është pjesërisht i bazuar, në kuptimin e asaj se heqja e mundësisë të ofertohet me Epidemiolog është diskriminuese, pasi është ministria përkatëse e cila përcakton kërkesat dhe kualifikimet e stafit për ti pajisur kompanitë me licencë për ushtrimin e veprimtarisë DDD. Në të njëjtën kohë nuk pajtohemi me pretendimin e OE ankues se "as nuk duhet të jetë Agronomi apo ekologu", pasi siç e cekëm më lart, është ministria përkatëse që i dikton kërkesat edhe kualifikimet e stafit për ti pajisur kompanitë me licencë për dezinfektim (DDD). Meqenëse ushtrimi i kësaj veprimtarie, kërkesat dhe kualifikimet përcaktohen nga institucioni përkatës (me rastin e licencimit), konsiderojmë se nuk është kompetencë autoriteteve kontraktuese e as e OSHP-së përcaktimi i kualifikimeve përderisa kompania është licencuar. Për këtë problematikë kemi disa vendime te OSHP-se qe janë përshkruar me lart ne këtë raport. Andaj propozojmë që të korrigjohet dosja duke lejuar gjitha profesionet që parashihen në licencë të ministrisë përkatëse për ushtrimin e kësaj veprimtarie."

Konstatimi i dytë (II): "Vlerësimi ekspertit është se pretendimi ankimor është i bazuar. Për më tepër konsiderojmë se kërkesa për Teknik të veterinarisë duhet të hiqet në tërësi pasi nuk është relevante me aktivitetin për dezinfektim të "objekteve qeveritare" dhe konsiderojmë se është kundërshtim me nenin 51 par.3 të LPP-së."

Konstatimi i tretë (III): "Pretendimet ankimore tjera siç janë numri punëtorëve, numri mjeteve/pajisjeve, repelentët e zvarranikëve etj , për të cilat OE ankues konsideron se janë të pamjaftueshme dhe të papërshtatshme për realizimin e kësaj kontrate, vlerësojmë se mbetet në përgjegjësi të AK-së caktimi i këtyre kërkesave pasi eksperti shqyrtues nuk ka kapacitetin profesional/logjistikën për të identifikuar dhe diktuar AK-së numrin e punëtorëve dhe numrin/llojet e mjeteve/preparateve për realizimin e kësaj kontrate."

Sipas të thënave më sipër, eksperti shqyrtues i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive të pretendimet e operatorit ekonomik ankues "Doctor Exterminator Ddd Sh.P.K.", Argumentimi në raportin e ekspertit shqyrtuese është mjaft i detajuar, i kuptueshëm dhe i bazuar tërësisht dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e ekspertit mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat kanë ofertuar tenderuesit. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues i ka falur besimin e plotë raportit të eksperteve. Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimet e operatorit ekonomik ankues "Doctor Exterminator Ddd Sh.P.K.", janë të bazuara.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK nuk është pajtuar rreth rekomandimeve të raportit të ekspertit shqyrtues dhe ekspertit teknik, ndërsa OE nuk ka dhënë përgjigje lidhur me mendimin e ekspertit.

- *Gjetjet e Panelit Shqyrtues –*

Bazuar në shkresat e kësaj lënde, Paneli konsideron se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, në kuptim të nenit 24 paragrafit 1 të Rregullores së Punës së OSHP, duke marrë parasysh faktin që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritor.

Paneli shqyrtues vlerëson se Raporti i ekspertit shqyrtues, i hartuar me kërkesën e Panelit lidhur me kontestin në këtë lëndë të aktivitetit të prokurimit publik, përmban elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilit kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë Panelin dhe të gjitha palët në konteste me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore.

Mirëpo duhet theksuar faktin ligjor se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Panelin shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjerë, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit, prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, raportin e ekspertit dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjykimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të Ligjit të Prokurimit Publik.

Paneli shqyrtues vlerëson se Raporti i ekspertit shqyrtues, i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive pretendimet e Operatorit Ekonomik ankues, raporti është bazuar tërësisht në dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit dhe konstatimet në raportin e ekspertit mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit. Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues i ka falur besimin e plotë raportit të ekspertit, sipas të cilit pretendimet ankimore të Operatorit Ekonomik ankues, janë vlerësuar si të bazuara.

Paneli shqyrtues e mbështet vlerësimin e eksperti shqyrtues lidhur me pretendimin ankimor 1, ku propozon që të korrigjohet dosja duke lejuar gjitha profesionet që parashihen në licencë të ministrisë përkatëse për ushtrimin e kësaj veprimtarie, andaj heqja e mundësisë të ofertohet me Epidemiolog është diskriminuese, pasi është ministria përkatëse e cila përcakton kërkesat dhe

kualifikimet e stafit për ti pajisur kompanitë me licencë për ushtrimin e veprimtarisë DDD.

Paneli shqyrtues e mbështet vlerësimin e eksperti shqyrtues lidhur me pretendimin ankimor 2, kërkesa për Teknik të veterinarisë duhet të hiqet në tërësi pasi nuk është relevante me aktivitetin për dezinfektim të "objekteve qeveritare" dhe konsiderojmë se është kundërshtim me nenin 51 par.3 të LPP-së.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa duhet të aprovohet si e bazuar. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur që duhet të përmirësohet Dosja e tenderit/ Njoftimin për Kontratë e Autoritetit Kontraktues lidhur me aktivitetin e prokurimit "Shërbime për Deratizim, Dezenfiktim, Dezinsektim për Ndërtesat Qeveritare -Ri tender" me numër të prokurimit: "214-23-13757-2-1-1" pasi që është vlerësuar se Autoriteti Kontraktues nuk ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore.

Paneli shqyrtues konstaton se përmisimi i Dosjes së Tenderit do të ofrohej mundësi më të madhe për pjesëmarrje të OE-ve ne aktivitetin e prokurimit, duke mos dëmtuar apo duke mos ulur cilësinë e produkteve/ushqimeve të kërkuara. PSH konsideron se gjithë AK-të duhet të kenë kujdes të shtuar në mënyrë që kriteret e përzgjedhjes nuk do të duhet te jenë padrejtësisht te rrepta që qojnë deri tek diskriminimi dhe kufizimi i konkurrencës, si dhe për të siguruar konkurrencë sa më madhe të mundur, pa rrezikuar kontraktimin e kompanive joprofesionale si dhe me qëllimin e kuptueshëm për të filtruar dhe përjashtuar kompanitë e paqëndrueshme të cilat nuk mund që të zbatojnë kontratën specifike, kështu që kriteret e përzgjedhjes duhet të përmbushin objektivin e saj dhe praktikisht të filtrojnë kompanitë e paqëndrueshme, në raport me vëllimin dhe kompleksitetin e punëve të parapara në aktivitet, por jo në masë që kriteret e vendosura të shpijnë në diskriminim dhe në paqëndrueshmëri dhe kundërshtim me dispozitat ligjore.

Paneli shqyrtues bazuar në faktin e aprovimit të ankese të OE, vendosi të kthehet tarifa e ankesës në shumën e deponuar nga operatori ekonomik ankues bazuar në nenin 31 par. 4 të Rregullores së Punës së OSHP.

Paneli shqyrtues konstaton se kthimi i një aktiviteti të prokurimit për përmirësim të Dosjes së Tenderit, me fakte dhe prova dhe/ose me bazë ligjore, është në harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, cituar: "...të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji". Sido që të jetë për secilën kërkesë të vendosur nga AK në Dosjen e Tenderit, duke u bazuar në nenin 24, paragrafi 2 i LPP, Autoriteti kontraktues është përgjegjës për të siguruar që të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoritetit të tillë kontraktues të ekzekutohen në përputhshmëri të plotë me këtë ligj. Po ashtu edhe sipas nenit 51, paragrafi 3 i LPP, AK duhet që gjitha kriteret e përzgjedhjes si dhe dokumentet dhe informatat e kërkuara që janë vendosur dhe përshkruar në këtë nen, duhet të jenë drejtpërdrejt relevante dhe proporcionale në raport me lëndën e kontratës përkatëse.

Paneli Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryetar i Panelit Shqyrtues

Isa Hasani

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- AK - **MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME**
- OE - **DOCTOR EXTERMINATOR DDD SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: